



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 nëntor 2019

Nr. ref.: RK 1468/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI16/19

Parashtrues

“Bejta Commerce”

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, [E.Rev.nr.20/18], të 31 korrikut 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar në emër të kompanisë “Bejta Commerce”, nga Basri Kçiku dhe Adem Kçiku, (në tekstin mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Përfaqësues i parashtruesit të kërkesës është Basri Kçiku nga Gjilani.

Vendim i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 20/18] të 31 korrikut 2018 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 178/2016] të 21 marsit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [IV.C. nr. 570/14] të 12 korrikut 2016 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar me 24 shtator 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para ligjit], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 janar 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 janar 2019, kërkesa e parashtruesit kishte arritur dhe ishte regjistruar në regjistrin e Gjykatës.
8. Më 6 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
9. Më 12 shkurt 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzonte në Gjykatë autorizimin për përfaqësim

dhe kopjen e fletëkthesës që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.

10. Më 19 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
11. Më 6 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me kërkesë të Komunës së Gjilanit, specifikisht në bazë të një kontrate të pashkruar (gojore), në dakordësi me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, prej 28 dhjetorit 2011, kishte kryer punë ndërtimore, përkatësisht shtruarjen e rrugëve, ndërsa Komuna e Gjilanit nuk kishte kryer detyrimin financiar për punën e kryer.
13. Si rezultat i mospërmbushjes së detyrimit të lartcekur nga Komuna e Gjilanit, parashtruesi i kërkesës, në një datë të paspecifikuar, kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, duke kërkuar nga Komuna e Gjilanit që ta përmbush detyrimin financiar për shkak të shkaktimit të dëmit material në vlerë prej 787.552,48 euro.
14. Më 12 korrik 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [IV.C.nr.570/14] refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Themelore në arsyetim të Aktgjykimit kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të dëshmojë pretendimin e tij se kishte një kontratë të lidhur me Kryetarin e Komunës së Gjilanit. Për më tepër, në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore kishte nënvizuar se edhe po të kishte një kontratë gojore, e njëjta nuk do të prodhonte efekte juridike pasi që Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht neni 630 paragrafi 2 i tij, parasheh detyrimin që kontratat e ndërtimit duhet të bëhen në formë të shkruar .
15. Në një datë të pa specifikuar, parashtruesi i kërkesës e kontestoi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit duke pretenduar: (i) shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike; dhe, (iii) zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 21 mars 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.178/2016] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke ritheksuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar ndonjë marrëdhënie kontraktuese me Komunën e Gjilanit.
17. Më 16 prill 2018, parashtruesi i kërkesës ushtroi revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar: (i) shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe, (iii) tejkalim të kërkesëpadisë.

18. Më 31 korrik 2018, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 20/2018] refuzoi si të pa bazuar revizionin dhe vërtetoi aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.
19. Në aktgjykimin e saj për refuzimin e revizionit, Gjykata Supreme ndër të tjera arsyetoi se: *“Nga fakti se paditësi ka dështuar të argumentoi se me të paditurën ka krijuar marrëdhënie të detyrimeve, pretendimi i cekur në revizion lidhur me zbatimin e nenit 4 të LMD-së në rastin konkret u vlerësua si i pabazuar. Gjithashtu nga arsyet e cekura me lart nuk gjen zbatim as neni 6 i ligjit të cekur, sepse nuk janë krijuar marrëdhëniet juridike ndërmjet pjesëmarrësve. Andaj, qëndrimin juridik se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, si të drejte e të bazuar në ligj e aprovon edhe kjo Gjykatë e revizionit.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin [E.REV.nr.20/2018] e 31 korrikut 2018, të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para ligjit], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta *“janë nxjerrë me shkelje të rënda të ligjit në fuqi dhe në dëm të parashtruesit të kësaj kërkeje dhe shkelje të të drejtave të tyre themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventa Ndërkombëtare [...] që të dy gjykatat e lartpërmendura kanë dështuar të vendosin drejtë dhe paanshëm në çështjen juridike të parashtruesit të kësaj kërkeje.”*
22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *“Nga provat të cilat i bashkëngjiten kësaj kërkeje vërtetohet se parashtruesi i kërkesës ka kryer punët e përmendura ne emër dhe në llogari të Komunës së Gjilanit në vlerë prej 678,898.69 euro, te cilat janë pranuar pa vërejtje nga Organi Mbikëqyrës i Komunës së Gjilanit, mirëpo ky fakt është anashkaluar në dëm të parashtruesit të kësaj kërkeje me aktgjykimet e gjykatave të lartpërmendura dhe si të tilla kane shkelur të drejtat e njeriut pasi që parashtruesi të kësaj kërkeje nuk është aprovuar kërkesëpadia, edhe pse ka dëshmuar se ka kryer punët e precizuara në Raportin e lartpërmendur.”*
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon po ashtu se kishte kryer punë ndërtimore për Komunën e Gjilanit në bazë të një kontrate gojore të lidhur me Kryetarin e Komunës së Gjilanit. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe një Raporti të Komisionit të Komunës të 28 dhjetorit 2018, në bazë të të cilit parashtruesi pretendon se vërtetohet që ka kryer punë ndërtimore për Komunën e Gjilanit. Lidhur me këtë parashtruesi pohon se *“ky fakt është anashkaluar nga*

ana e tri gjykatave të lartpërmendura, me aktgjykimet e të cilave parashtruesit të kësaj kërkesë i janë shkelur të drejtat e tija themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikë së Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare, pasi parashtruesit të kësaj kërkesë nuk është aprovuar kërkesëpadia, edhe pse ka dëshmuar se ka kryer punët e precizuara në Raportin e lartpërmendur në vlerë prej 678,898.69.”

24. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme dhe ta kthejë rastin në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dispozita ligjore relevante:

**LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE
VI. FORMA E KONTRATËS**

Neni 55

Sanksioni për mungesë të formës së nevojshme

- 1. Kontrata që nuk është e lidhur në formën e parashikuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se nga qëllimi i dispozitës me të cilën është caktuar forma nuk del diçka tjetër.*
- 2. Kontrata që nuk është lidhur në formën e kontraktuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se palët e kanë kushtëzuar vlefshmërinë e kontratës me formë të veçantë.*

KONTRATA PËR NDËRTIMIN

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 645

Nocioni

- 1. Kontrata për ndërtim është kontratë me të cilën kryerësi detyrohet sipas projektit të caktuar të ndërtojë në afatin e caktuar ndërtesën e caktuar në tokën e caktuar, apo në një tokë të tillë respektivisht në objektin tashmë ekzistues të kryejë punë të tjera ndërtimi, ndërsa porositësi detyrohet që për këtë t'i paguajë çmimin e caktuar.*
- 2. Kontrata për ndërtimin duhet të jetë e lidhur me shkrim.*

Neni 646

Objektet ndërtimore

Me fjalën "Objektet ndërtimore" në kuptim të kësaj pjese konsiderohen ndërtesat, digat, urat, ujësjellësi, kanalizimi, rrugët, vijat hekurudhore, tunelet, pusët dhe objekte të tjera ndërtimore, ndërtimi i të cilave kërkon punë më të mëdha dhe më të ndërlikuara.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata se pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113, [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtuesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, par.14).
29. Gjykata, gjithashtu, vlerëson nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet së pari neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E.REV.nr.20/2018] e Gjykatës Supreme të 31 korrikut 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
31. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me paragrafin (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”
32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesa pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3, 7, 21, 24, 31, 53, 54 dhe 119 të Kushtetutës. Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk i ka arsyetuar pretendimet e tij për shkelje të neneve 3, 7, 21, 24, 53 dhe 119 të Kushtetutës, ndërsa pretendimet për shkelje të neneve 31 dhe 54 të Kushtetutës i ndërton mbi bazën se Gjykata Supreme nuk i ka trajtuar në mënyrë të drejtë provat e rastit kur kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për revizion.
33. Gjykata nënvizon që në përputhje me kërkesat e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës dhe mbi bazën e praktikës së saj gjyqësore, në shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ).
34. Gjykata thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton parimin themelor se drejtësia e një procedure gjyqësor vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo*

kundër Spanjes, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës K1104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe K1143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

35. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta për arsye procedurale, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë faktin se ka pasur një kontratë me shkrim me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, gjersa forma me shkrim e kësaj kontrate kërkohet shprehimisht sipas nenit 55 [Sanksioni për mungesë të formës së nevojshme] dhe nenit 645 [Kontrata për Ndërtimin] të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesës relevante të arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ku theksohet se: *"Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, sepse nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, del se paditësi me te paditurën nuk kane lidhur kontrate me shkrim siç e parasheh neni 630. 2 te LPK-së i cili nen ka përcaktuar se kontrata e ndërtimit lidhet ne formën me shkrim, ndërsa neni 70.1 ligjit të cekur ka përcaktuar se kontrata e cila nuk është e lidhur në formën e parashikuar, nuk ka efekt juridik. Me të drejt gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se ndërmjet palëve nuk është nënshkruar kurrfarë kontrate mbi ndërtimin me të cilën do të ishin caktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve, andaj konstatimin se nuk ka bazë të vlefshme juridike për realizimin e shpërbëmit të këtyre punimeve, si të drejtë e të bazuar në ligj e vlerëson edhe kjo Gjykate e Revizionit. Nga fakti se paditësi ka dështuar të argumentoi se me të paditurën ka krijuar marrëdhënie të detyrimeve, pretendimi i cekur ne revizion lidhur me zbatimin e nenit 4 të LMD-së në rastin konkret u vlerësua si i pabazuar. Gjithashtu nga arsyet e cekura me lart nuk gjen zbatim as neni 6 i ligjit të cekur, sepse nuk janë krijuar marrëdhëniet juridike ndërmjet pjesëmarrësve. Andaj, qëndrimin juridik se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, si të drejtë e të bazuar në ligj e aprovon edhe kjo Gjykate e revizionit."*
37. Gjykata vëren se revizioni ishte refuzuar nga Gjykata Supreme për arsye se parashtruesi i kërkesës nuk kishte arritur të provojë se ishte në marrëdhënie të detyrimeve me Komunën e Gjilanit ashtu siç përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhënie të Detyrimeve.
38. Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesit i është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesë argumente dhe prova të cilat i ka konsideruar të rëndësishme për rastin e tij.

39. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
40. Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta.
41. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
42. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 7 [Vlerat] dhe nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm që nenet e Kushtetutës, të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore, nuk kanë efekt të pavarur pasi efekti i tyre vlen vetëm për “*gëzimin e të drejtave dhe lirive*” që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit e të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me “*gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut*” (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI67/16, parashtrues i kërkesës *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).

43. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktgjykimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
44. Si rezultat, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe, si e tillë shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarija e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi